



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sh.II nr.753/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit shpk nga fshati-Komuna e Drenasit me përfaqësues J.P. kundër debitorit shpk nga Vushtria, me bazë juridike përmbartimore për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri CPP.nr.959/20 të datës 31.03.2021, jashtë seancës me datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit shpk nga fshati Komuna e Drenasit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.959/20, të datës 31.03.2021, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri me aktvendimin e atakuar, CPP.nr.959/20, të datës 31.03.2021, e ka miratuar si të bazuar prapësimin e debitorit shpk nga Vushtria, dhe ka shfuqizuar urdhërimin për lejimin e përmbartimit privat P.nr.1064/20 dt.30.10.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të pranohet në tërësi ankesa si e bazuar dhe urdhëri i përmbartuesit privat P.nr.1064/2020 të mbetet në fuqi, apo qështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës.

Gjyqtari individual i Dhomës së Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori shpk nga fshati Komuna e Drenasit, me datë 30.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit shpk nga Vushtria, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës, me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit për furnizim, t'ia paguajë shumën prej 713,60€uro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Përmbareuesi Privat Fatos Shatri me seli në Pejë duke vepruar sipas propozimit për përmbaremore të kreditorit ka lejuar përmbaremoren me urdhrin P.nr.1064/2020 të datës 30.10.2020, ndërsa kundër këtij urdhri, debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar të gjitha faturat dhe borxhin e pretenduar nga kreditori sepse asnjëherë nga kreditori nuk ka pranuar faturat në emër të këtij borxhi dhe se këto fatura nuk i janë ofruar asnjëherë debitorit, dhe në fund ka propozuar që të anulohet propozimi për përmbaremore dhe urdhëri për lejimin e përmbaremore dhe të aprovohet prapësimi i debitorit.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori me datë 27.11.2020, duke theksuar pretendimet se ka kaluar kohë e gjatë që debitori nuk i ka paguar faturat vullnetarisht, i njëjti është furnizuar në vlerë prej 18,670.48€ prej të cilave debitori i ka paguar 15,380.48€ ndërsa pjesa tjetër është borxh i pa kryer për qka kemi nis procedurë përmbaremore.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar CPP.nr.959/208, të datës 31.03.2021, ka vendosur që ta miratoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj Urdhërin për lejimin e përmbaremore të përmbareuesit privat P.nr.1064/20 dt.30.10.2020.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se prapësimi është i bazuar për faktin se fatura si dokumenti besueshëm me nr.... dt.19.04.2019 në vlerë prej 713.60€ në anën e debitorit është vënë nënshkrimi mirëpo jo edhe vula e debitorit si person juridik, andaj gjykata në mungesë të provave për vërtetimin e prapësimin të kësaj fature konstaton se kjo faturë nuk është pranuar nga debitori nuk është konfirmuar si e pranuar nga debitori. Fatura në fjalë nuk i plotëson kushtet e kërkuara për tu konsideruar dokument i besueshëm dhe të veprohet me përmbaremore. Gjykata e shkallës së parë është referuar në dispozitat e nenit 29 pa.1 nenp.1.3 të LPP-së dhe nenit 245 të LMD-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të faturës si dokument i besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument jo të besueshëm siç janë faturat e furnizimit, në shumë prej 713.60€, pasi që nuk është dokumentuar se debitori ka pranuar këto fatura përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar për tu dëshmuar se ky subjekt juridik ka pranuar faturat. Prandaj Dhoma e shkallës së dytë pranon konstatimet se këto fatura të prezantuara nga kreditori nuk i plotësojnë kushtet për tu konsideruar si dokumente të besueshme dhe të veprohet në procedurë të përmbarimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit të paraqitura në ankesë lidhur me pretendimet se aktvendimi i atakuar është në kundërshtim me vetë veten, dhe se provat janë vlerësuar në mënyrë jo të drejtë dhe jo ligjore. Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se këto pretendime janë të pabazuara, dhe se vendimi i atakuar është i drejtë dhe ligjor duke u bazuar edhe në prova të bazuara të cilat paraqesin gjendjen faktike.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Sh.II.nr.753/22 me datë 23.08.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha